



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:114315
Datë: 13.12.2024
Numri i dokumentit: 06596422

Rev.nr.373/24

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Rrustem Thaqi, kryetar i kolegjit, Beshir Islami dhe Muhamet Rexha, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike - kontestimore të paditësit: Sh. B. nga H. i E., të cilin e përfaqëson Mimoza Kuka - Bushi avokate në K., sipas autorizimit, kundër të paditurës: KEK sh.a., me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson J. M., sipas autorizimit, për shkak të kompensimit të dëmit material - rentës mujore, duke vendosur lidhur me revizionin e paditësit të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.7046/21, të datës 11.06.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 05.12.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet i pabazuar revizioni i të paditurës: KEK, me seli në Prishtinë, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.7046/21, të datës 11.06.2024.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj - Dega në Kaçanik C.nr.82/17 të datës 07.07.2021, është vendosur: I. Miratohet, në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Sh. B. nga H. i E. dhe detyrohet e paditura KEK sh.a., me seli në Prishtinë, që paditësit t'ia paguaj rentën siç vijon : I/a Për periudhën e kaluar prej datës 08.05.2016 (prej kohës kur ka pushuar të punojë), e deri më 31.03.2021, datën kur është bërë ekspertiza, shumën prej 15.303 €. Në këtë shumë edhe kamatën në vlerë prej 2,843 €, duke filluar nga data e 24.04.2017 (data e paraqitjes së padisë), e deri më datën, 31.03.2021, kur është përpiluar ekspertiza nga eksperti aktuar. I/b Për periudhën e ardhshme duke filluar nga data 01.04.2021, e tutje deri sa për këtë të ekzistojnë kushtet ligjore, për çdo muaj t'ia paguaj shumën prej 260 €, respektivisht 430 €, nga dita kur ti ndërpritet marrja e pensionit të veteranit paditësit, kjo pagesë mujore do të paguhet më së voni

deri më datën 5 të muajit të ardhshëm. II. Detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguaj shumën në pikën I/a dhe I/b, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 1.808 €, të gjitha këto pagesa do të bëhen në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit në dorëzim, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, me aktgjykimin Ac.nr.7046/21, të datës 11.06.2024, ka vendosur: Refuzohet e pabazuar ankesa e të paditurës Korporata Elektroenergjetike e Kosovës sh.a., me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj - Dega në Kaçanik, C.nr.82/17 i datës 07.07.2021, vërtetohet.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, në afat ligjor ka paraqitur revizion e paditura, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet revizioni i të paditurës si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i shkallës së parë C.nr.82/17 i datës 07.07.2021, si dhe aktgjykimi i shkallës së dytë Ac.nr.7046/21, i datës 11.06.2024, të prishen dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje, apo të ndryshohen dhe të refuzohet kërkesëpadia si e pabazuar.

Përgjigje në revizionin e të paditurës ka paraqitur paditësi, me propozim që të refuzohet revizioni i të paditurës në tërësi si i pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se:

Revizioni i të paditurës është i pabazuar .

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, më datë 24.04.2017, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të paditurës, për shkak të kompensimit të dëmit material - rentës mujore, me të cilën ka kërkuar si në precizimin e padisë sipas parashtresës së datës 12.03.2020.

Gjykata e shkallës së parë, duke vendosur sipas padisë së paditësit, kundër të paditurës, pas vlerësimit dhe administrimit të provave, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor ka nxjerr aktgjykimin C.nr.82/17 të datës 07.07.2021, me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë, ndër të tjera ka theksuar se: me qëllim të vlerësimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me këtë çështje, gjykata ka bërë administrimin e provave dhe atë: fletëparaqitjen për fatkeqësinë në punë, aktgjykimin C.nr.... të datës 10.07.2015, kontratën e punës, vërtetimin e datës 12.05.2016, përgjigjen në padi, aktgjykimin Rev.nr...., aktgjykimin Rev.nr...., aktgjykimin Ac.nr...., pasqyrën e llogarisë nga trusti, vërtetimin e pa punësisë, ekspertizën e ekspertit aktuar, aktgjykimin Rev.nr....., plotësimin e ekspertizës të bërë në seancë dhe me shkrim.

Ka shtuar se gjykata pas analizimit të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës kërkesëpadinë e paditësit e miratoi në tërësi si të bazuar dhe e detyroi të paditurën që paditësit t'ia paguaj dëmin material në emër të fitimit të humbur, sepse i njëjti këtë dëm e ka pësuar me fajin e të paditurës. Ky fakt është konstatuar nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës edhe atë aktgjykimet C.nr.... të datës 10.07.2015, Ac.nr.... dhe Ref.nr...., si dhe në mbështetje të dispozitave të nenit 179.2 të LMD-së. Me këtë dispozitë është paraparë se në qoftë se i lezionuari për shkak të pa aftësisë së plotë ose të pjesshme për punë e humb fitimin, ose nevojat i janë shuar vazhdimisht

apo mundësitë e zhvillimit të tij të mëtejshëm dhe të përparimit janë zhdukur ose janë pakësuar, personi përgjegjës ka për detyrë t'ia paguaj të lënduarit tani paditësit rentën e caktuar në të holla si kompensim për këtë dëm.

Ka theksuar se gjykata e miratoi në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe e detyroi të paditurën që t'ia kompensoj dëmin sepse paditësi këtë dëm e ka pësuar me fajin e të paditurës, ndërsa sa i përket lartësisë së dëmit gjykata e ka marrë për bazë ekspertizën e aktuarit. Eksperti ka konstatuar se për periudhën e kaluar prej datës 08.05.2016 (prej kohës kur ka pushuar të punojë), e deri më 31.03.2021, datën kur është bërë ekspertiza, paditësit i takon shuma prej 18.146 €, në emër të rentës për periudhën e kaluar si dhe shumën prej 2,843 €, në emër të kamatës, duke filluar nga data 24.04.2017 (data e paraqitjes së padisë), e deri më datën 31.03.2021, kur është përpiluar ekspertiza nga eksperti aktuar. Po ashtu eksperti ka konstatuar se për periudhën e ardhshme duke filluar nga data 01.04.2021, e tutje deri sa për këtë të ekzistojnë kushtet ligjore, për çdo muaj t'ia paguaj shumën prej 260 €, e cila shumë mujore do të paguhet më së voni deri më datën 5 të muajit të ardhshëm.

Ka theksuar se gjykata e ka detyruar të paditurën që paditësit t'ia paguaj rentën mujore për periudhën e ardhshme në shumë prej 260 €, respektivisht 430 €, nga dita kur ti ndërpritet marrja e pensionit të veteranit paditësit. Gjkata e ka caktuar pagesën, në këtë formë duke u bazuar në neni 16 të Ligjit Nr. 04/L-261, për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Ka theksuar se gjykata i analizoi theksimet e të autorizuarës së paditësit, e cila i propozoi gjykatës që ta miratoj kërkesëpadinë e paditësit, këtyre theksime gjykata u'a fali besimin dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, sepse paditësi këtë dëm e ka pësuar pa fajin e tij, me fajin e të paditurës, fakte të konstatuara nga provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ndërsa lartësinë e kërkesës e ka vërtetuar nga ekspertiza e ekspertit të aktuar, mirëpo një e drejtë e tillë i takon paditësit, konform nenit 136 paragrafi 1 dhe 177 paragrafi 2 të LMD-së.

Po ashtu gjykata e ka analizuar edhe pretendimin e palës së paditur, e cila ka theksuar se kërkesa është parashkruar, sepse rasti ka ndodhur në vitin 2012, ndërsa paditësi padinë e ka paraqitur në vitin 2017. Gjkata këto theksime nuk i mori për bazë me rastin e vendosjes sepse paditësit të ardhurat personale i janë ndërprerë në vitin 2016 gjegjësisht më datën 08.05.2016, ndërsa padinë e paditësit për pagimin e rentës e ka paraqitur më datën 24.04.2017. Po ashtu paditësit kjo e drejtë i ka lindur që nga vërtetimi i aktgjykimit C.nr.... të datës 10.07.2015, i cili aktgjykim është vërtetuar me aktgjykimin Ac.nr.... të datës 09.05.2019, me të cilin është vërtetuar aktgjykim i shkallës së parë.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë, i është referuar nenit 136 paragrafi 1, 177 paragrafi 2 dhe 179 LMD-së, neni 16 të Ligjit Nr. 04/L-261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Për shpenzimet e procedurës ju ka referuar nenit 452 paragrafi 1 të LPK-së.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, e paditura ka paraqitur ankesë, ndërsa gjykata e shkallës së dytë me aktgjykimin e saj Ac.nr.7046/21, të datës 11.06.2024, ka vendosur që ta refuzojë ankesën e të paditurës, ndërsa aktgjykimin e atakuar ta vërtetojë, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata Apelit në arsyetim të aktgjykimit ndër të tjera ka theksuar se: nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare, në kuptim të nenit 194 të LPK-së. Gjendja faktike del të jetë vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë, ku edhe janë dhënë arsye të mjaftueshme rreth mënyrës se vendosjes të cilat i pranon si të rregullta edhe kjo gjykatë. Aktgjykimi i ankimuar po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 al.2, pika n). Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, pasi që aktgjykimet nuk janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Pretendimet e paraqitura në revizion se aktgjykimet e instancave me të ulëta janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) e LPK-së, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk janë të bazuara.

Pretendimi se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për shkak se dispozitivi është kundërthënës me vetveten dhe me arsyet e dhëna në të është pretendim i pabazuar, për shkak se aktgjykimi në strukturë dhe përmbajtje është në përputhje me nenin 160 të LPK-së, dispozitivi është i hartuar në mënyrë të rregullt, dhe si i tillë i plotëson kushtet e përcaktuar me dispozitat e LPK-së, ndërsa arsyetimi i aktgjykimit është në përputhje të plotë me mënyrën e vendosjes. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare, mënyrën e vërtetimit të fakteve, mënyrën e vlerësimit dhe çmuarjes së provave nga ka rezultuar se gjendja faktike e konstatuar dhe e kualifikuar në përputhje me të drejtën materiale ka përcaktuar pasojën juridike më decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë. Gjykata ka dhënë arsye bindëse për faktet thelbësore të marra në vlerësim, për mënyrën e vërtetimit të fakteve thelbësore që në këtë rast janë konstatuar me anë të provave të administruara gjatë shqyrtimit kryesorë në shkallë të parë.

Për shkakun e njëjtë nuk qëndrojnë as pretendimet në raport me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, sepse gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare

ekzaminohet aktgjykimi. Gjykata e shkallë së dytë ka dhënë arsyetim për të gjitha pretendimet ankimore duke i vlerësuar në pajtim me dispozita ligjore, por ka gjetur me të drejtë se pretendimet ankimore janë të pabazuara.

Pretendimet e paraqitura në revizion nga e paditura se aktgjykimi i shkallës së parë dhe të dytë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 277 të LPK-së, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk është i bazuar, për arsye se:

Me nenin 277 të LPK-së, dhe nenin 11, të Ligjit Nr. 04/L-118, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, me të cilin është riformuluar neni 277 i ligjit bazik, përcaktohet se: “ Procesi gjyqësor ndërpritet: a) kur pala ndërgjyqëse vdes ose e humbë zotësinë procedurale; b) kur përfaqësuesi ligjor i palës vdesë ose shuhet autorizimi i tij për përfaqësim, e pala nuk ka të caktuar përfaqësues me prokurë në gjykim; c) kur pala që është person juridik pushon së ekzistuari, respektivisht kur organi kompetent jep vendim të formës së prerë për ndalimin e punës tij; d) kur paraqitet propozimi për fillimin e procedurës së falimentimit në kontestet në të cilat i padituri është debitor falimentues; e) kur për shkak të luftës ose për shkaqe të tjera pushon puna në gjykatë; f) kur ndërprerja e gjykimin parashihet me ndonjë ligj tjetër ”.

Nga interpretimi i nenit 277 të LPK-së, rezulton qartë se ndërprerja e procesit gjyqësorë mund të bëhet kryesisht vetëm në gjykatën e shkallës së parë, që nga momenti kur paraqitet padia në gjykatë e deri në përfundimin e procesit gjyqësorë (shqyrtimit kryesorë - në shkallë të parë) dhe përjashtimisht në gjykatën e shkallës së dytë dhe atë: nëse gjykata e shkallës së dytë vendosë për ankesën në seancë të trupit gjykues ose në bazë të shqyrtimit të çështjes në seanca gjyqësore, siç përcaktohet me nenin 190 të LPK-së, dhe në këto raste gjykata e shkallës së dytë duhet të veproj në kuptim të nenit 191, 192 dhe 193 të LPK-së. Në këtë rast gjykata e shkallës së dytë nuk ka vendosur për ankesën në bazë të shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore sepse nuk janë plotësuar kushtet ligjore siç përcaktohen me nenin 190 të LPK-së, e nga kjo rezulton se neni 277 i LPK-së, nuk ka mundur të zbatohet në këtë rast. Përveç të cekurave gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi dhe ka dhënë arsyetim për të gjitha pretendimet ankimore duke i vlerësuar në pajtim me dispozita ligjore, por ka gjetur me të drejtë se pretendimet ankimore janë të pabazuara.

Baza juridike e kërkesëpadsisë, që e paditura të jetë përgjegjëse për të kompensuar dëmin-gjegjësisht fitimin e humbur paditësit, gjenë mbështetje në nenin 154 dhe 158 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimit i datës 30 Mars 1978, i cili ka hyrë në fuqi më datë 01 Tetor 1978.

Me nenin 154 të LMD-së, përcaktohet se: “ Kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë të ja kompensoj, në çoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij ”, me nenin 158 të këtij ligji, përcaktohet se: “ Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje apo nga pakujdesia ”.

Gjykata Supreme e Kosovës e pranon qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë dhe gjykatës së shkallës së dytë, për zbatimin e drejtë të drejtës materiale, në përputhje me gjendjen faktike të provuar në këtë rast edhe për kundër faktit se është dashtë të zbatohen dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimit të datës 30 Mars 1978, i cili ka hyrë në fuqi më datë 01

Tetor 1978, dhe jo të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 16/19 Qershor 2012, i cili ka hy në fuqi nga data 20 dhjetor 2012 me tej LMD) Ligji Nr.04/L-077, mirëpo duke pas parasysh se dispozitat e ligjit të vjetër nuk kanë dallime substanciale, me ligjin që kanë aplikuar gjykatat e instancave më të ulëta, gjykata konsideroj se vendimi është i drejt dhe i ligjshëm.

Baza juridike nuk ka qenë kontestuese sipas revizionit, prandaj Gjykata Supreme në këtë pjesë sa i përket zbatimit të dispozitave materialo - juridike është kufizuar, duke qenë se deklarimi për bazën është çështje që i referohet disponibilitetet të kërkesave për të cilën palët mund të disponojnë lirishtë në këtë rast.

Nuk qëndron pretendimi i të paditurës se kërkesa e paditësit për kompensimin e dëmit në formë të rentës është parashkruar për arsye se:

Me nenin 360 paragrafi 1 të LMD-së, përcaktohet se: “ Me parashkrim pushon e drejta e kërkimit të përmbushjes së detyrimit ”, ndërsa me paragrafin 2 të po këtij neni, përcaktohet se: “ Parashkrimi lind kur të ketë kaluar afati i caktuar me ligj, brenda të cilit kreditori ka mundur të kërkoj përmbushjen e detyrimit ”.

Me nenin 361 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: “ Parashkrimi fillon të rrjedh ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër ”.

Me nenin 376 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: “ Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri (3) vite nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe për personin, që e ka bërë dëmin”.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore e duke u bazuar në këtë gjendje faktike, Gjykata Supreme e Kosovës erdhi në përfundim se gjykata e shkallë së parë drejt ka aplikuar të drejtën materiale dhe ka vërtetuar se e drejta e paditësit për të kërkuar kompensimin e dëmit - rentën, ndaj të paditurit nuk është parashkruar, për arsye se paditësit të ardhurat personale - mujore i janë ndërprerë në vitin 2016, gjegjësisht më datën 08.05.2016, ndërsa padinë paditësi për pagimin e rentës e ka paraqitur më datë 24.04.2017, e nga kjo rezulton se nga momenti i ndërprerjes së të ardhurave personale të paditësit, e deri në paraqitjen e padisë në gjykatë nuk kanë kaluar 3 vite, çka do të thotë se kërkesëpadia e paditëses nuk është parashkruar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykata e shkallës së parë dhe e dytë me rastin e vendosjes, drejtë kanë aplikuar të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, lidhur me pjesën e kërkesëpadisë për kompensimin në formë të rentës së arritur nga data 08.05.2016 – 31.03.2021, së bashku me kamatën dhe në formë të rentës mujore për periudhën pas datës 01.06.2018, e derisa të ekzistojnë kushtet ligjore për arsye se me nenin 188 paragrafi 1 të LMD-së përcaktohet se: “ Në rast të vdekjes, të lezionimit trupor ose të dëmtimit të shëndetit, kompensimi caktohet, si rregull në formë të rentës në të holla, për gjithë jetën ose për një kohë të caktuar ”, ndërsa në paragrafin 2 të po këtij neni përcaktohet se: “ Renta në të holla e gjykuar për efekt të kompensimit të dëmit paguhet për çdo muaj përpara në çoftë se gjykata nuk cakton diçka tjetër ”. Në këtë rast gjykata duke iu referuar kërkesës së paditësit ka lejuar që me anë të ekspertizës financiare - të aktuaristikës të bëhet llogaritja e rentës së arritur për pagesë dhe llogaritjes së rentës mujore për periudhën e ardhshme dhe nga kjo ekspertizë

gjykata ka konstatuar se fitimi i humbur - renta e arritur për periudhën kohore të kaluar prej datës 08.05.2016 (prej kohës kur ka pushuar të punojë), e deri më 31.03.2021, datën kur është bërë ekspertiza, shumën prej 15.303.00 €, si dhe kamatën në vlerë prej 2,843.00 €, duke filluar nga data e 24.04.2017, e deri më datën, 31.03.2021, si dhe për periudhën e ardhshme duke filluar nga data 01.04.2021, e tutje deri sa për këtë të ekzistojnë kushtet ligjore, për çdo muaj t'ia paguaj shumën prej 260 € , respektivisht 430 €, nga dita kur ti ndërpritet marrja e pensionit të veteranit paditësit.

Gjykata Supreme e Kosovës, e ka pranuar rentën edhe për periudhën e ardhshme duke pas parasysh ekspertizën e cila vlerësimin e ka mbështetur në rrethanën objektive për t'a nxjerrë lartësinë dhe atë në shkallën e zvogëlimit të aktivitetit punues dhe në këtë kuptim eksperti iu ka referuar kontratës së punës e cila ka qenë e lidhur në mes të paditësit dhe të paditurës. Gjykata Supreme e Kosovës e pranon si të besueshme, profesionale dhe të argumentuar mirë ekspertizën e aktuaristikës dhe vlerëson se gjykata e shkallë së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë për këtë kategori të dëmit sepse vlerësimi i gjykatës është në harmoni edhe me vlerësimin e ekspertit mjekësor i cili ka konstatuar se paditësi ka shkallë të zvogëlimit të aktivitetit punues 100%.

Përveç të cekurave nga përmbajtja e dispozitave ligjore të LMD-së, rezulton se: Fitim i humbur është një lloj i veçantë i dëmit material. Ky lloj i dëmit ekziston kur i dëmtuari pengohet për t'iu rritur pasuria. Nëse i referohemi dispozitave të LMD-së, rezulton se fitimi i humbur mund të realizohet kumulativisht me dëmin real, nëse ekzistojnë kushtet e caktuar për të.

Fitimi i humbur sipas dispozitave të LMD-së, nënkupton vetëm atë fitim për të cilin është i sigurt se kreditori sipas rrjedhës së rregullt të gjerave ose sipas rrethanave të veçanta të rastit do ti realizojë.

Shpërblimi i dëmit material për shkak të lëndimit trupor dhe dëmtim të shëndetit përfshin shpenzimet e shërimit, të rehabilitimit për të dëmtuarin. Në këto shpenzime përfshihen: barërat, intervenimet mjekësore, furnizime me proteza, për shërim klimatike... etj.

Shpërblimi i dëmit material për lëndime trupore dhe për dëmtimin e shëndetit përfshinë edhe fitimin e humbur, për shkak të zvogëlimit të aftësisë punuese të përhershme të dëmtuarit, i cili si pasojë e lëndimit e humbë aftësinë punuese, fitimin e të ardhurave personale dhe zvogëlimin e pasurisë. Në këto raste shpërblimi i dëmit bëhet në formë të rentës në të holla.

Sipas dispozitave të LMD-së, shpërblimi i dëmit material në formë të rentës vjen në shprehje në këto raste: a) në rast të vdekjes së personit prej të cilit i dëmtuari ka humbur ushqimin; b) në rast të lëndimit trupor dhe dëmtimit të shëndetit ka pësuar zvogëlim të aktivitetit jetësor punës në shkallë të caktuar, dhe si pasojë ka pësuar zvogëlim të pasurisë apo humbje të të ardhurave personale, dhe c) në rast të lëndimit trupor dhe dëmtimit të shëndetit janë rritur nevojat e të dëmtuarit në aspektin e ndihmës së personit të huaj, ushqimit të përforcuar, shërimit klimatik apo në ndonjë mënyrë tjetër.

Në rast të vdekjes, lëndimit trupor, shpërblimi caktohet në formë të rentës në të holla, për gjithë jetën ose për një kohë të caktuar. Vepohet kështu për arsye se pasojat kanë të bëjnë me dëmtimin trupor, humbjen apo zvogëlimin e aftësisë punuese, humbjen ose zvogëlimin e të ardhurave etj. Të gjitha këto e vështirësojnë jetën e të dëmtuarit, e renta në këtë rast caktohet me qëllim të sigurimit të ekzistencës së të dëmtuarit.

Me dispozitat e LMD-së, është përcaktuar mundësia që nëse debitori nuk e jep sigurimin të cilin e cakton gjykata, kreditori ka të drejtë të kërkojë që në vend të rentës t'i paguhet një shumë e përgjithshme, lartësia e të cilit do të caktohet sipas lartësisë së rentës dhe kohëzgjatjes së mundshme të jetës së kreditorit, me zbritje të kamatave përkatëse. Po ashtu për shkaqe serioze kreditori mundet edhe në raste të tjera të kërkojë menjëherë ose më vonë, që në vend të rentës t'i paguhet një shumë e përgjithshme. Mirëpo këto janë përjashtim dhe aplikohen vetëm nëse ekziston rreziku që më vonë nuk mund ta realizojë kërkesën kreditori.

Sipas dispozitave të LMD-së, kriteret për caktimin e lartësisë së shpërblimit me të holla të dëmit material janë: a) lartësia e dëmit, b) shkalla e fajit, c) gjendja materiale e të dëmtuarit, dhe d) gjendja materiale e dëmtuesit. Lartësia e dëmit caktohet duke pasur parasysh kriterin objektiv dhe subjektiv. Kriteri objektiv ka të bëjë me vlerësimin e dëmshpërblimit sipas vlerës reale në treg të së mirës së dëmtuar, ndërsa kriteri subjektiv vjen shprehje tek rastet kur dëmi material është shkaktuar me vepër penale me dashje, në këtë rast gjykata mund të caktojë lartësinë e shpërblimit të dëmit sipas vlerës që ka pasur sendi për të dëmtuarin. Nëse vlerësimi i dëmit bëhet sipas kriterit subjektiv atëherë sigurisht se lartësia e dëmshpërblimit do të jetë më e madhe se çmimi real i tregut që do të kishte dëmshpërblimi eventual.

Përveç tjerash caktimi i shumës së rentës në të holla, varet nga shkaku për të cilin është gjykuar ky lloj i shpërblimit të dëmit. Nëse është për humbjen e ushqimit apo për zvogëlimin ose humbjen e mundësisë së realizimit të fitimit, në rast të lëndimit trupor ose dëmtimit të shëndetit, për caktimin e saj duhet vlerësuar të gjitha rrethanat që ndikojnë në të. Këto rrethana mund të ndryshojnë me kalimin e kohës. Ndryshimi mund të ndodhë ashtu që dikush nga të dëmtuarit - paditësit, për shkak të moshës apo për ndonjë arsye tjetër e humbë të drejtën e ushqimit nga personi tjetër, për të cilën arsye mund të kërkohej ndryshimi i aktgjykimit me të cilin atij i është caktuar shpërblimi në këtë lloj të dëmit. Në këtë kontekst me kalimin e kohës mund të kërkohej edhe ndryshimi i shumës së rentës, varësisht nga ndryshimi i rrethanave, të cilat kanë ndikuar në caktimin e shumës së saj. I dëmtuari por edhe dëmtuesi kanë mundësinë të paraqesin kërkesën që të rishqyrtohet kërkesa për rentë, edhe për kundër faktit se rasti ka përfunduar me aktgjykim të formës së prerë. Me rastin e paraqitjes së kërkesës pala duhet të paraqes prova se kanë ndryshuar rrethanat të cilat gjykata i ka pasur parasysh me rastin e nxjerrjes së vendimit të mëparshëm. Çka përbën rrethanë të ndryshuara gjykata duhet në secilin rast të vlerësojë në bazë të provave të paraqitura dhe varësisht nga besueshmëria e tyre të marrë edhe mendimin e ekspertëve që në mënyrë të plotë të vërtetojë nëse kemi të bëjmë me rrethanë të ndryshuar.

E drejta për shpërblimit e dëmit në formë të rentës në të holla, për shkak të lëndimit trupor dhe të dëmtimit të shëndetit është e drejtë personale e lidhur ngushtë me personalitetin e të dëmtuarit dhe nuk mund të bartet e as të trashëgohet.

Për hir të praktikës gjyqësore edhe pse në praktikën gjyqësore, e në veçanti në gjykatat e instancave më të ulëta, si në gjykatën e shkallës së parë ashtu edhe në gjykatën e shkallës së dytë, e në disa raste edhe në këtë gjykatë, në të kaluarën rreth parashkrimit të drejtës për të kërkuar rentën e arritur dhe rentën për të ardhmen (fitimin e humbur), ka pasur dilema dhe vendimmarrje ndryshe, këto nuk janë me ndikim për vendimmarrje ndryshe nga kjo gjykatë sepse secili vendim gjyqësor me të cilin përfundon procedura kontestimore mund ti nënshtrohet kontrollit të ligjshmërisë sipas mjeteve të goditjes të rregullta dhe të jashtëzakonshme ashtu siç është

përcaktuar me dispozitat ligjore të LPK-së, mirëpo është fakt jokontestues se praktika gjyqësore si burim i së drejtës mund të përdoret vetëm kur ajo është krijuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, si e vetmja gjykatë kompetente në bazë të Ligjit Për Gjykata, për krijimin e praktikës gjyqësore, si me mendime juridike, ashtu edhe me vendime gjatë vendosjes sipas mjeteve të jashtëzakonshme juridike.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, me vendimet e saj është qartësuar se e drejta për të kërkuar rentën e arritur dhe rentën për të ardhmen (fitimin e humbur), nuk parashkruhet (afati i parashkrimit nuk fillon nga momenti kur ka ndodh rasti/lëndimi i të dëmtuarit) siç pretendon e paditura, mirëpo nga momenti/koha e ndërprerjes së të ardhurave personale të paditësit, e deri në paraqitjen e padisë në gjykatë, e në këtë rast nuk kanë kaluar 3 vite, çka do të thotë se kërkesëpadia e paditëses nuk është parashkruar.

Pretendimet për gjendjen faktike të paraqitur në revizion nga e paditura nuk janë vlerësuar pasi që sipas nenit 214 paragraf 2, të LPK-së, përcaktohet se: “ Revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike ”.

Gjykata Supreme e Kosovës, me rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka vlerësuar të gjitha pretendimet sipas revizionit të paraqitur nga e paditura, për të cilat ka konstatuar se kryesisht i referohen zbatimit të gabuar të së drejtës materiale sa i përket fitimit të humbur - rentës së arritur dhe rentës për të ardhmen, dhe parashkrimit të kërkesës, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe në pajtim me nenin 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
Rev.nr.373/24, datë 05.12.2024.

Kryetar i kolegjit
Rrustem Thaqi